



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 199, datë 17.04.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES {...}

**DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 86, DATË 20.02.2024, TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 86, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, znj. Klodian Kurushi,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 86 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR